Asambleja
01.Nr.VII
Deçan,dt.31.07.2023

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e VII-të, të rregullt të Kuvendit, me dt.31.07.2023.
Në mbledhje ishin prezent:22 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale (6), OSBE, OJQ.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit Rinorë,
3. Shqyrtimi i Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë;
4. Shqyrtimi i Planit të mobilitetit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i model rregullores për taksat komunale;
6. Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës,
7. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor financiar;
8. Shqyrtimi i Projekt – Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave;
9. Shqyrtimi i Draft- Planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Deçanit 2023-2025;
10. Themelimi i Komisionit për ndarjen e bursave për student;
11. Përgjigjet e drejtorit të drejtorisë për Shërbime Publike në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit (të cilat dorëzohen me shkrim në Zyre të Kryesuesit deri me dt.27.07.2023);
12. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e VII-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 22 anëtarë të kuvendit (mungojnë: Armend Loshaj, Floriana Hulaj, Fekri Qufaj, Hyri Dobrunaj, Shkelqim Tolaj), në vazhdim kryesuesi e prezantoj rendin e punës të propozuar me ftesë, pastaj ka thënë se është rekomandim i KPF-së, që pikat nr,3 dhe 4 të hiqen nga rendi i ditës me arsyetimin se nuk janë paisë asamblistët me material për këto dy pika, si dhe ka propozuar që në të ndryshme të debatohet rreth raportit të Zyrtarit të pasurisë, të sjellë nga drejtoresha e drejtorisë për buxhet dhe financa, në vazhdim e ka hapë debatin rreth rendit të punës.
Yllarta Thaqi e ka ngritë si shqetësim çështjen e mungesës së ujit të pijes.
Albesa Cacaj- ka kërkuar sqarim pse nuk ka ardhë për shqyrtim në Kuvend Plani për barazi gjinore, i cili ka qenë në plan të punës së kuvendit në muajin mars.
Kryesuesi- sqaron se hartuesja e Planit për barazi gjinore, Ajne Ibëhysaj ka pasë rast vdekje dhe nuk ka pasë mundësi që ta përgaditë planin, por në muajin shtator do të vjen për shqyrtim ky plan, pastaj e qiti në votim rendin e punës pa pikat nr.3- Shqyrtimi i Planit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në komunë; dhe nr.4-Shqyrtimi i Planit të mobilitetit; me raportin e Zyrtarit të pasurisë, rend pune i cili miratohet njëzëri.
Kryesuesi pas miratimit të rendit të punës ka njoftuar se që nga muaji shtator seancat e kuvendit do të transmetohen live.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Miratohet njëzëri pa vërejtje.
II. Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit Rinorë.
Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj për sqarime fillimisht fjalën ia ka dhënë drejtoreshës së drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte, Leonora Ukëhajdaraj, si propozuese e këtij plani.
Drejtoresha ka sqaruar se kemi planifikuar që së pari të miratohet Plani e pastaj të themelohet KVRL, meqenëse vjen muaji i shtatorit dhe hapen shkollat e mundësitë për kontakte me të rinjët janë më të mëdha, mirëpo shqetësim ka qenë dhe mbetet financimi i KVRL-së, ka thënë ajo.
Orges Tafilaj- pyet, qe sa kohë KVRL nuk është aktiv, si Plan ka thënë ai është mjaft i mirë, dhe çështja tjetër që dua ta ngris ka të bëjë me pagesën ku parashihen dy përgjegjës aktiv me orar të shkurtuar me pagë mujore 75 euro, mirëpo nuk besoj se kjo pagë duhet me mbetë kështu por duhet të rritet.
Drejtoresha përgjigjet që nga Prilli i vitit 2019 nuk ka KVRL.
Vatan Istrefaj- thotë se është obligim i juaji themelimi i KVRL dhe financimi mos të mbetet vetëm në letër por të bëhet ky financim, përndryshe plani si dokument është i mirë.
Arjan Dobraj- thotë se plani i përmbushë të gjitha kriteret që kërkohen për një plan të tillë dhe kërkon që në fshatra me qenë ma aktiv në këtë drejtim.
Miftar Ahmetxhekaj-thotë se plani e ka një obligim buxhetor, në vitin 2023 prej ku merren mjetet buxhetore.
Drejtoresha ka dhënë sqarime.
Mon Selmonaj- thotë, te titulli me çfar ka të bëjë kjo organizatë e rinisë nuk janë cekë të gjitha karakteristikat, kurse çka presin të rinjët- ekzistojnë numri i veprimeve të ritë- kërkon sqarim, kërkon sqarim te KVRL si këshilltare e kryetarit, te buxheti ku ka të bëjë me pagesën ku parashihen dy përgjegjës aktiv me orar të shkurtuar me pagë mujore 75 euro, është shifër pa kuptim 75 euro, mendoj se aty duhet të jetë dikush përgjegjës por jo të paguhet në këtë shumë. Analizat te zonat rurale- nuk e di sa është reale kjo organizatë të monitoron shkollat, a është e qëlluar kjo, Analizat e nivelit të rinjëve në komunën tonë në zonat rurale –këtu mendoj se duhet të punohet ma shumë, poashtu ai kërkon që Buxheti për mbështetje të planit për vitet 2024-2026 duhet të planifikohet dhe miratohet me buxhet komunal.
Faton Selmanaj- pyet, çka ka ndodhë me zyrën e KVRL-së dhe me paisjet e tyre që kanë qenë në zyrë.
Drejtoresha përgjigjet se zyra ku kanë vepruar KVRL shfrytëzohet nga dikush tjetër kurse paisjet janë dhe ruhen në një zyrë tjetër.
Meqenëse nuk kishte diskutime tjera , Kryesuesi e qiti në votim në parim, asamblistët e miratojnë me 17 vota për dhe 5 abstenim. Miratohet Plani Lokal i Veprimit Rinorë dhe i njëjti i nënshtrohet procedurës së konsultimit publik.
Pikat III dhe IV janë hjekë nga rendi i ditës.
V. Shqyrtimi dhe miratimi i model rregullores për taksat komunale;
Kryesuesi- e ka prezentu model rregulloren për taksat komunale pastaj fjalën ia ka dhënë Yllarta Thaqi, Kryesuese e komisionit për hartimin dhe përpunimin e model rregullores.
Yllarta Thaqi, kryesuese e komisionit- ka thënë se si komision kanë punuar mjaft në përgaditjen dhe harmonizimin e kësaj model rregullore, komisioni ka qenë i përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike në kuvend, me përjashtim të LDK-së të cilët nuk e kanë sjellë emrin e përfaqësuesit të vet në komision, model rregullorja ka thënë ajo ka dalë edhe në diskutim publik dhe tani është verzioni final, mirëpo si komision kemi qenë të pasigurtë te një tarifë në drejtorinë për shërbime Pubilke- Vërtetimi për shërbim ushtarak, për të cilin kërkon sqarim nga drejtori- a është e nevojshme ende të mbetet kjo tarifë apo duhet të hiqet nga rregullorja kjo tarifë bashkë me lëshimin e atij vërtetimi.
Miftar Ahmetxhekaj-thotë, kërkoj falje që si grup nuk e kemi përfaqësuesin tonë në komision, ndërsa sa i përket rregullores kur ka të bëjë me masat e ndërmarra te ujrat e zeza, si ki mi trajtu këtë çështje

ti kur nuk ki fare kanalizim të ujrave të zeza në fshatrat anej bistrice, ndërsa te zonat, zona e dytë dhe e treta dallimet në tarifa nuk janë të harmonizuara dhe kjo gjë duhet të bëhet.
Drejtori, Izet Zenuni- sqaron se tarifa- vërtetim për shërbim ushtarak, duhet të mbetet në rregullore sepse ende ka kërkesa për një dokument të tillë, si për shembëll kërkohet si vërtetim 5-6 herë në vit nga bashkatdhetarët tanë në Kanada dhe vërtetimi lëshohet me dy dëshmitarë të personit që e kërkon.
Kryesuesi- e qiti në votim, meqenëse nuk kishte të interesuar tjerë për debat, antarët e kuvendit njëzëri e miratojnë Rregulloren për taksat komunale (22 prezent në sallë).
VI.Raporti i Kryetarit.
Kryesuesi- e ka prezentu raportin gjashtë mujor të punës së kryetarit të komunës, pastaj e ka hapë debatin rreth këtij raporti.
Vatan Istrefaj-ka thënë se materiali është mjaft voluminoz, vlenë të theksohet se ky raport ka të bëjë me punën që lidhet drejt për drejt me qytetarin, ka thënë se është cekë në raport se janë nënshkru 13 kontrata gjë që është mirë, mirëpo ende ka fshatra që nuk kanë ujë të pijes 24 orë si dhe rrugët kanë mbete ashtu si kanë qenë të parregulluara dhe këto janë gjana elementare për jetë.
Orges Tafilaj-kërkon që te mediat gjendja të paraqitet mirë dhe drejt, në vazhdim ka shtruar pyetjen në fq.12 vlera e motorrave Atv 6x6 dhe pjesëve shtesë çka është dhe ka kërkuar sqarim për të, ndërsa si lajm i mirë thotë se është punimi i draftit final të hartës Zonale sepse janë kërku për një kohë të gjatë hartimi i tyre, te shëndetësia i falënderojmë stafin për punën e mirë që e bëjnë dhe qasjen që kanë ndaj qytetarëve, te arsimi- rezultatet e nxënësve vërtetë janë për tu duartrokitë.
Mifar Ahmetxhekaj-thotë se ne këtu sot po flasim për raportin e punës së kryetarit, jo për veprimet procedurale të administratës sepse janë të panevojshme për shembëll futja në raport e vendimeve për pushim vjetor, janë veprime procedurale që janë ligjore, janë të vazhdueshme dhe kanë qenë të panevojshme të përfshihen në raport .
Yllarta Thaqi- thotë se raporti në pjesën e parë është mjaft i mirë ndërsa ka thënë se nuk duhet të përfshihen në raport emrat e individëve, ka pyet kush është zyrtar për mbledhje të detyrueshme në tatim në pronë.Te shëndetësia paisja me aparaturë të gjinekologjisë ka qenë mjaft e nevojshme dhe ju përgëzoj, vazhdoni ju me punu dhe ne na kini pas ka përfunduar ajo.
Faton Selmanaj- te shërbimet publike ka cekë- kanalizimi i ujrave të zeza në fshatin Dranoc dhe nuk di si pu jetojke aty nga ky kanalizmim, pyetja ime është, çka po ndodhë me impiantin në fshatin Dranoc.
Kryetari i Komunës, z.Bashkim Ramosaj-përgjigjet në çështjet e ngritura dhe pyetjet e shtruara nga asamblistët, sa i përket pyetjes rreth furnizimit me ujë të pijes, ai ka thënë se ju e dini që uji i pijes nuk është kompetencë komunale por është kompetencë e KRU që nuk na përgjigjet neve, nuk jemi përgjegjës për ujin e pijes por nuk jemi përgjegjës as nuk menaxhojmë edhe me ujin për vaditje të tokës, sa ju përket rrugëve, ne kemi pasë një marrëveshje me ministrinë për Llotin nr.3, kemi fillu në Dubravë, Shaptej dhe kemi me vazhdu në Strellc dhe sa kemi me arrite me punu nuk di sepse varet edhe nga përkrahja e ministrisë, për Orgesin përgjigje për pyetjen e shtruar për motorra, i kemi ble 30 biqikleta poashtu edhe paisje të tjera të kërkim shpëtimit për shtigjet malore sepse janë shënju shtigjet në bjeshkë dhe unë i falënderoj publikisht ata që kanë punu në këtë drejtim (Drejtoria ekonomisë) mirëpo hala jemi në fazën e promovimit të turizmit edhe pse i kemi ble këto paisje(edhe motorrat), Kryetari ka thënë se e kemi një fond nga shteti Italian në shumën prej 1 mil e 800 mi euro, fond i cili është për promovimin e turizmit malor për Komunat Deçan, Pejë, Junik. Te aktet administrative(përgjigje për Miftarin) jemi pjesë e matjes së performancës sepse nëse nuk përputhen këto të dhëna gjatë monitorimit të komunës nuk po vlerësohet me pikë fare atëherë. Për Yllarten-Zyrtar për mbledhje të detyrueshme në tatim në pronë, është zyrtari në tatim në pronë sepse mund të dënohemi për mos respektim të afatit, për Fatonin (impianti në fshatin Dranoc) nuk kemi mujtë me i pagu shpenzimet e rregullimit të impiantit nga buxheti komunal sepse është projekt që kushton shumë, aty duhet mu vendosë edhe një trafo nga KEDS dhe krejt ky aktivitet ka mu krye deri në shtator.

Albesa Cacaj- fq.92 pika 23 ku thotë se është projekt në gjashtë mujorin e dytë të vitit, dhe pyetja ime këtu është kurë kanë me fillu punimet për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve për në Bjeshkë të madhe, për të cilën kryetari përgjigjet se nuk kanë me fillu këtë vit.
Kryesuesi e mbylli debatin rreth raportit të punës gjashtë mujore të kryetarit të komunës.
VII. Raporti 6 mujor financiar.
Kryesuesi e prezentoj raportin 6 mujor financiar pastaj e hapi debatin rreth tij.
Mon Selmonaj te vendimet gjyqësore- për 6 muaj 55 vendime, kryetari në një takim të mëhershëm ka thënë se kanë përfundu kontratat në vepër, kurse këtu po vjen raporti me dhjetëra e dhjetëra emra ku tregon se po paguhen ata puntorë me kontratë në vepër.
Miftar Ahmetxhekaj- e kemi marrë raportin me shumë shpenzime të cilat unë i quaj shpenzime të kqia, siq janë subvencionet, karburantet, dreka zyrtare pagesa e puntorve me kontratë në vepër, shërbimet intelektuale- çka paguhet këtu, ku paguhen zyrtarët komunal, Te Higjiena- mirëmbajtja rutinore- pyetja ime çka është. Qeratë e banesave- a janë të nevojshme pagesat e këyre qerave dhe a kini marrëveshje paraprake për pagim të qeras së banesës dhe e fundit Veturat me qera cilat janë.
Drejtoresha e buxhetit, Dafina Cacaj- përgjigjet në pyetjet e shtruara, ajo thotë se vendimet gjyqësore –paga dhe mëditje (për Monin) janë shujtat e arsimit, kontratat për shërbime të veçanta, janë ato pagesa që janë borgje të papaguara të kontratave të mëhershme, kurse kontrat tjera janë ndërpre, shërbimet intelektule janë pagesat që bëhen për të gjitha komisionet e kuvendit dhe ekzekutivit që paguhen në këtë kod , te pagesat per qera –paguhen qera per familjet me nevojë që jetojnë me qera, Veturat me qera-janë veturat e kryetarit dhe nën kryetarit, tjerat makina janë të vjetra në pronësi të komunës. Mirëmbajtja rutinore është kontrata n'shpi që i paguajmë faturat që na i bjen Higjiena.
Orges Tafilaj-thotë se i kemi problemet e mëhershme te raporti. Te vendimet gjyqësore përmbarimore Raporti i auditorit ka me tregu se e keni dëmtu buxhetin prap sepse kryetari ka bërë premtime për investime kapitale dhe ndoshta ndonjë herë ka me hy në obligime pa e pasë buxhetin ose në bazë të një premtimi të ardhshëm por kompanitë nuk na presin dhe i kërkojnë mjetet e tyre, pagesat për karburante janë koxha të mëdha. Vërejtjetet e auditorit të kaluara duhet me i marrë parasyshë dhe shum seriozisht kur i bëjmë pagesat e shpenzimeve të ndryshme.
Albesa Cacaj-shpenzimet te zyra e kuvendit- 2000 euro te Petrol Kompani, pyet pse është bërë gjithë ky shpenzim dhe kërkon të ipet sqarimi.
Florim Mataj- u ngrit si shqetësim kontrata në vepër dhe shpenzime intelektuale, mirëpo në mungesë të stafit janë angazhu këta puntorë dhe unë po du me thane këta njerëz ta kryejn punën e vet si duhet.
Meqenëse nuk kishte të tjerë të interesuar për debat, kryesuesi e mbylli debatin rreth raportit 6 mujorë të shpenzimeve.
VIII. Shqyrtimi i Projekt – Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave.
Kryesuesi e prezentoj si pikë pastaj për sqarime fjalën ia kaloj drejtorit të Shërbimeve Publike.
Izet Zenuni, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, ka sqaruar se Projekt-rregullorja e prezentuar është Model rregullore e re e hartuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, kërkoj nga ju që sot ta kalojmë si dokument dhe bashkë ta përgadisim dhe ta harmonizojmë dokumentin final.
Albesa Cacaj- thotë se ne kemi mjaft rregullore të miratuara por është e rëndësishme që ato të zbatohen, jo veq formalisht mu miratu, sepse jemi lodhë tuj miratu rregullore që nuk po zbatohen.
Drejtori, Izet- thotë se rregullorja e parë për Menaxhimin e mbeturinave është miratuar në vitin 2019 dhe zbatohet 95%.
Yllarta Thaqi- si draft është tepër e mirë dhe ju përgëzoj.
Orges Tafilaj- pyetje, çka ka ndodhë me hapsirën e caktuar për deponi inerte e caktuar me vendim të kuvendit, fq,16. Parapagimi 10% për konsumatorët që paguajnë për një vit është në rregull, kurse 5% parapagim për 6 muaj se di a është në rregull dhe sa ka me pasë efekt dhe propozimi im është të hiqet 5%-shi komplet për 6 muaj mëqë vlera prej 1.80 euro është e vogël dhe nuk i cyt konsumatorët që të parapaguajnë në krahasim me 10% (7.2 euro në vit). Dhe në fund një rekomandim i fundit për Komisionin e akcionerve:të shikohet që të rritet inkasimi nga konsumatorët komercial mëqë është diku rreth 53% në krahasim me inkasimin nga konsumatorët e amviserisë ku është mbi 90%.

Kësisoj arrihet të përmisohet gjendja financiare e kompanisë dhe balancimi i llogarive të arkëtueshme me ato të pagueshme.
Faton Selmanaj- te mbikëqyrja e inspektimeve janë disa hapsira publike që edhe pse pastrohet prap ndotet ambienti prandaj kërkoj që të ndërmerren hapa konkret nga inspekcioni.
Izet Zenuni- ka sqaruar te parapagimi 10% dhe te 5%, ai ka thënë se kemi parasyshë këtë vërejtje dhe do ta shqyrtojmë, te deponitë ilegale që ne i pastrojmë vazhdimisht kjo ndodhë sepse është mungesë e deponisë ku mund ti hedhin mbeturinat dhe veprimeve të qytetarëve që i hedhin ato vend e pa vend.Zingjiri i inspekcionit funksionon por jo aq sa duhet sepse ne nuk e kemi një inspektor komunal për shërbime publike-është mungesë e vendosjes së gjobave.
Kryesuesi- thotë ta miratojmë në parim dhe tia hapim rrugën për shqyrtim, ndryshim dhe plotësim të mëtutjeshëm, pastaj e qiti në votim, Anëtarët e Kuvendit njëzëri(21 prezent) e miratojnë në parim, e njëjta i nënshtrohet procedurës së konsultimit publik.
IX. Shqyrtimi i Draft- Planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Deçanit 2023-2025.
Kryesuesi- e prezentoj Draft-Planin komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Deçanit 2023-2025, pastaj ka sqaruar se propozuesi i këtij Plani, Artan Ismajlaj nga ZLK, ka qenë prezent në KPF për të dhënë sqarime, por sot mungon për arsye familjare, andaj sot kërkoj nga ju që të kini mirëkuptim dhe ta shqyrtojmë dhe miratojmë në parim dhe meqenëse kërkohet të del si dokument në konsultim publik.
Miratohet në parim si dokument në leximin e parë dhe del në diskutim publik (miratimi bëhet me 14 vota pro).
X. Themelimi i Komisionit për ndarjen e bursave për student.
Kryesuesi- e prezentoj këtë pikë, pastaj sqaroj se komisioni duhet të përbëhet nga 7 anëtarë, 4 nga Asambleja, 2 nga Ekzekutivi dhe 1 OJQ lokale. Në vazhdim propozohen kandidatët dhe formohet Komisioni për ndarjen e bursave për studentë në këtë përbërje: 4 anëtarë nga Asambleja, Lendita Berisha-AAK, Arjan Dobraj-AAK, Albesa Cacaj-LDK, Orges Tafilaj-LVV, dy nga Ekzekutivi, Manjolla Shala dhe Zeqë Malaj, një OJQ-Adem Lushaj.
Kjo përbërje e komisionit miratohet njëzëri.
Drejtori i Drejtorisë për Arsim ka thënë se kërkohet që sot të formohet edhe komisioni për ankesa për ndarjen e bursave për student që sipas rregullores duhet të përbëhet nga 3 anëtarë, të dy këto komisione i raportojnë kuvendit për punën e tyre.
Poashtu formohet edhe komisioni për ankesa, i cili duhet të shqyrton ankesat studentëve që nuk është ndarë bursa për studentë, komisioni formohet në këtë përbërje: Dy nga Asambleja, Leotrim Hadergjonaj-AAK dhe Vatan Istrefaj-LDK, një nga Ekzekutivi DKA, Besart Cacaj.
XI. Përgjigjet e drejtorit të drejtorisë për Shërbime Publike në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit (të cilat dorëzohen me shkrim në Zyre të Kryesuesit deri me dt.27.07.2023);
Kryesuesi e ka prezentu ketë pikë dhe pastaj e ka ftuar drejtorin, Izet për të dhënë sqarime.
Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Izet Zenuni, ka sqaruar se kanë ardhë dy pyetje me kërkesat e Vatan Istrefaj dhe Blinera Lokaj, pastaj përgjigjet se sa ju përket vendosjes së Shenjave të komunikacionit- është mungesë që nuk ka mujtë mu kry kjo punë por javën tjetër do të kryhen, te pyetja e Blinerës Ndriçimi publik në fshatin Sllup është nalë për shkak të pagesës, tash pagesa është krye dhe brenda jave lëshohet ndriçimi publik.
Në vazhdim drejtori përgjigjet në pyetjet e drejtuara me shkrim me të cilat është paisë kuvendi me material, si më poshtë.
1.Pyetja: Siç mund të i shikoni të gjitha rrugët lokale në Komunën e Deçanit janë bërë me rrezik për të lëvizur me vetura, për shkak të rritjes së drunjëve, degëve, therrave, e barishteve të cilat i kanë kapluar gjysmën e hapësirës së rrugëve.
Kjo i rrezikon edhe qytetarët që lëvizin këmbë, nxënësit etj, të cilët në mungesë të trotuareve i shfrytëzojnë rrugët për lëvizje.
Pyetja është se çfarë keni bërë si drejtori, për krasitjen dhe pastrimin e hapësirave anësorë përgjatë gjitha rrugëve në Komunën e Deçanit ?

-Përgjigja e drejtorit - Pastri i rrugëve dhe largimi i vegjetacionit, kjo punë fillon me 15 gusht.
2.Pyetja: Meqenëse Ndërmarrja "Higjiena" po funksionon jashtëzakonisht mirë, pse nuk i keni përfshi në kuadër të kontratës "N'shpi" edhe pastrimin e mirëmbajtjen e varrezave në të gjitha fshatrat e komunës së Deçanit, e jo vetëm tri (siç janë të cekura në kontratën aktuale), përderisa menaxhmenti i kësaj ndërmarrje janë deklaruar se kanë kapacitete të mjaftueshme për ta kryer këtë shërbim ?
Dhe a keni mundësi ju lutem ta realizoni edhe këtë shërbim ndajë qytetarëve?
- Përgjigja e drejtorit-Te Ndërmarrja Higjiena që kërkohet që ta kryen pastrimin e varrezave, sqaron se kanë mu futë si pozicion te kontrata "N'shpi", Mirëmbajtja e varrezave dhe heqja e vegjetacionit.
3.Pyetja;Meqenëse është shfaqur pengesë me caktimin e lokacionit aktual për deponin inerte, çfarë veprimesh keni marrë si drejtori që të zgjidheni këtë problem, dhe kur mendoni se do te jetë në funksion, në mos aty ku ishte planifikuar, në ndonjë lokacion adekuat për deponi inerte?
-Përgjigja e drejtorit - Lokacioni për deponi inerte- po është kthye vendimi negativ dhe kërkohet shfuqizim i atij vendimi, i cili do të bëhet sot.
4.Pyetja: Siç shihet gjithandej Deçani është kapluar me reklama të lloj llojshme dhe gjithandej publike e private, si e menaxhoni si drejtori këtë çështje?
A do te filloni verifikimin e vendosjes se reklamave, qoftë ato të operatoreve ekonomik (që kanë licenc nga komuna) qoftë atyre të bizneseve, apo individuale, për ti aplikuar kriteret e reklamave, llojet dhe madhësitë e tyre, qëllimin e përdorimit dhe pajisjen me leje?
- Përgjigja e drejtorit- Te reklamat, është shumë e drejtë, por do të caktohet një model i njëjtë për të gjitha reklamat që do të bëhen dhe kjo do të behet në momentin që miratohet Plani zhvillimor komunal.
5.Pyetja: Tashmë dihet që në udhëkryqet e rrugës "Elez Geci & Maxhun Berisha" konkretisht ne udhëkryqin tek fshati Llukë e Epërme dhe Pozharë numri i aksidenteve është i madhë, ne të dy vendet fatkeqësisht ka pasur edhe aksidente me fatalitet... pse nuk i vendoseni shenjat e komunikacionit (te cilat janë dëmtuar nga aksidentet dhe pengesat (policët e shtrirë) ne udhëkryqet kryesore të rrugës që të shpijnë nga Deçani ne Lumbardh, përkundër kërkesave te vazhdueshme të komunitetit? (arsyetimi qe nuk lejon ministria tanimë nuk qëndron sepse një pengës e tillë është vendosur nga Komuna vetëm për një familje në këtë pjesë).
- Përgjigja e drejtorit – sa i përket pyetjes, Vendosja e policëve të shtrirë, është bërë vendosja e policëve të shtrirë te kryqi i Pozharit, në një udhëkryq në fshatin Llukë afër një biznesi do të vendosen shpejt.
6.Pyetja:Është e domosdoshme vendosja e shenjave te komunikacionit dhe she njëzimi i rrugës, po ashtu ndonjë polic i shtri në fshatin Strellc i Ulet, rruga qe te lidhë me Lybeniq, udhekryqi te Lufaj dhe tjerë..? A e keni konstatuar këtë gjendje, dhe kur pritet të ketë veprime konkrete?
7. A keni ndërmarrë veprime konkrete për vendosjen e shenjave të komunikacionit ne të gjithë territorin e Deçanit?

-Shenjat lajmëruese në gjitha hyrjet e fshatrave me mbishkrimin e emrit te fshatit?
-Vendosja e shenja te komunikacionit ne qytet dhe fshatra që janë dëmtuar nga aksidentet (sepse përkundër premtimeve nuk kemi vërejtur qe ka përmirësim në këtë drejtim?
-Vendosjen e shenjave lajmëruese afër shkollave (p.sh. te shkolla e fshatit Strellc i Eperm, por edhe tek shkollat tjera), si dhe polic të shtrire në perimetrin afër shkollave??
-Përgjigja e drejtorit-Pengesat në trafik- rrethi te Ukaj dhe te lagja Lufaj në fshatin Strellc të Ulët do të vendosen (përgjigje për pyetjen e Vatanit).
8.Pyetja:A keni kontratë me ndonjë kompani për mirëmbajtje, që do ti kryente edhe shërbimin, si ç bllokimi i urave (gypave për ujitje, si rasti në fshatin Strellc i Eperem, tek Mahmudemjat, qe kalon rrugën kryesore) por edhe për vendosjen e shakteve, te cilat dëmtohen apo vjedhjen?
-Përgjigja e drejtorit- Po, Kemi kontratë me Higjienën.
9.Pyetja:Kur pritet të largohen këto trafot e KEDS-it te cilat janë të vendosura ne trotuaret përgjatë rrugës kryesore nga Deçani deri ne Carrabreg?

-Përgjigja e drejtorit-Kemi shumë kërkesa për mu largu por nuk varen nga ne.
10.Pyetja:A keni bërë ndonjë plan, që trotuaret rrugës së qendrës mos të parkohen në trotuar, pasi që qytetarët që lëvizin këmbë po detyrohen të ecin rrugës?
- Përgjigja e drejtorit-Ne i kemi vendosë shenjat, por është kompetencë e policisë dhe zyrtari për transport publik me i largu.
Miftar Ahmetxhekaj- pyet, a kini mundësi për këtë çështje mu koordinua me komandantin e policisë.
11.Pyetja: Si qëndron bashkëpunimi me KEDS-in për vendosjen e shtyllave te reja nga betoni, te transmetuesve te rrymës, ne lokalitetet që nuk janë vendosur?
- Përgjigja e drejtorit- Afër 36 projekte KEDS i ka dorëzua në komunë për lëshimin e Pëlqimit, por kurë do të kryhen ata e dinë.
12.Pyetja:A e keni arritur të bëni zgjidhje për stacionin e autobusëve ne rrugën kryesore qe është rregulluar tani, ne Isniq, pjesën tjetër te rrugës, faktikisht pasi te hysh ne rrugën me katër korsi, qe i bjen rruga nga Isniqi ne drejtim te Deçanit?
- Përgjigja e drejtorit-Në momentin kurë vendoset shtresa e tretë e asfaltit do të vendoset edhe stacioni i autobusëve.
13.Pyetja: Hapësirat publike ne qendër te Deçanit janë duke u keqpërdorur, rasti me i keq është tek lokalet ku është stacioni i autobusëve, qe presin udhëtarët me shkua ne drejtim te Pejës (stacioni përballë Postes) ajo pjesë e trotuarit publik shfrytëzohet me pa të drejt nga kafiterit dhe bizneset tjera, si tarasë apo vendosjen e gjerave afariste, ndërsa nxënësit dhe udhëtaret detyrohen të qëndrojnë ne rrugë, madje ka ankesa nga qytetarët se familjaret e tyre dhe nxënësit detyrohen te shkojnë këmbë tek kanali për ta pritur autobusin vetëm te ju shmangen kontakteve me njerëz te shumte qe qëndrojnë te ulur me karrike e tavolina ne vendin ku do te duhej te qëndronin ata qe presin për të udhëtuar?
- Përgjigja e drejtorit- Në këtë pyetje u përgjigj kryetari dhe unë nuk kam çfar shtoj më tepër.
14.Pyetja: Kur fillon projekti i elektrifikimit të fshatrave?
Për sa kohë përfundon?
Dhe si është planifikimi i punimeve, renditja e fshatrave në implementimin e projektit?
-Përgjigja e drejtorit-Është shqetësuese kjo- ato dalin në trotuarë, por vetëm një pjesë paguajnë qera.
15.Pyetja : Si është dinamika e punimeve ne lotin 3, ne cilat fshatra keni punuar, në cilat tjera këtë vit keni me filluar?
Pse nuk ka filluar projekti nga fshatrat me emrin e te cilave është emërtuar projekti dhe është votuar buxheti si i tillë: "Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Strellc i Eperm, Strellc i Ulet, Llukë e Eperme, Dashinoc, etj" dhe kur do te filloni se realizuar punimet ne këto fshatra, pasi qe qytetarët janë në pritje, sepse e kanë shiku dhe degju se vitin e kaluar Kuvendi i Komunës kështu e ka votuar buxhetin për këtë projekt?
-Përgjigja e drejtorit-Është projekt detal që është ka punohet dhe nuk dihet ende kostoja pastaj dihen edhe afatet kohore.Në qershore ka pasë me fillu pore është vonu, dhe fshati i parë që ka me fillua është Baballoqi, kjo punë fillon në muajin gusht, Te Lloti Nr.3 e tha edhe kryetari në raportin e punës.
Vatan Istrefaj- pyet, te policët e shtrirë- a ka mundësi me i vendosë shpejt apo vet qytetarët i vendosin.
Orges Tafilaj- për trafo pyet, a janë të vendosura në pronë komunale , për të cilën drejtori përgjigjet, po në pronë komunale janë të vendosura. Orgesi për ujë të pijes- në Elena Gjikë janë nja 10 shtëpi që nuk kanë ujë qe tre muaj, pyetja ime është, çka do të ndërmerrni në këtë rast për këta qytetar. Poashtu ne si Kuvend patem themeluar një komison për të diskutar me Hidrodrinin. Nëse nuk është më funksional, atëherë bashkarisht të themelojmë një komision tjetër ose të gjindet mënyra që problemi të zgjidhet. Drejtori përgjigjet se ne ju bëjmë presion kompanisë, përndryshe nuk jemi kompetent për ujë të pijes.
Yllarta Thaqi- pyet rreth veprimeve që do të ndërmerr kompania që i ka ba zbrazjen e ujit.
Vatan Istrefaj-sipas përgjigjeve që dha drejtori, asnjë zgjidhje për momentin nuk po shihet.
Meqenëse nuk kishte të interesuar të tjerë për diskutim, Kryesuesi e mbylli debatin rreth kësaj teme.

XII. Shqyrtimi i raportit të Zyrtarit për asete, e cila ka hy si pikë me kërkesën e Drejtoreshës së Drejtorisë për buxhet dhe Financa.
Kjo pikë njëzëri hiqet nda rendi i ditës, mbetet për të debatuar rreth saj në ndonjë nga mbledhjet e radhës.
XIII.Rishqyrtim i vendimeve të kuvendit me rekomandim të MAPL-së.
1.Shfuqizimi i Vendimit 01.Nr.XV-6 i datës 29.12.2022, për Caktimin e lokacionit për Deponi inerte (mbeturina të ngurta)Dhe,
2. Shfuqizimi i vendimit 01.Nr.IV-5/1 i dt.28.04.2023 për Caktimin e lokacionit për ngritjen e Ndërmarrjes së Kultivimit, Rritjes dhe Tregëtimit të fidanëve dekorative dhe frutore.
Njëzëri shfuqizohen dy vendimet (18 prezent).
SHFUQIZOHET VENDIMI 01.Nr.XV-6 i datës 29.12.2022, për Caktimin e lokacionit për Deponi inerte (mbeturina të ngurta), në Njësinë kadastrale nr.P-70505078-00062-0, Zona Kadastrale Hulaj, dhe në Njësinë kadastrale nr.P-70505021-00353-0, Zona Kadastrale Deçan, dhe
SHFUQIZOHET Vendimi 01.Nr.IV-5/1 i dt.28.04.2023 për Caktimin e lokacionit për ngritjen e Ndërmarrjes së Kultivimit, Rritjes dhe Tregëtimit të fidanëve dekorative dhe frutore, i cili ka qenë i caktuar në parcelën nr.00542-0, me sipërfaqe 611 m2, parcela nr.00545-0 me sipërfaqe 2303 m2, parcela nr.00544-0 me sipërfaqe 716 m2, parcela nr.00543-0 me sipërfaqe 771 m2, parcela nr.00550-0 me sipërfaqe 6117 m2 Njësia Kadastrale, Zona Kadastrale Deçan, e evidentuar si pronë komunale pronar-KOMUNA E DEÇANIT.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ